



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 253/1 Prot.

Tiranë, më 06.03.2026

V E N D I M

Nr. 52, datë 06 .03. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën Nr. 193 regj, datë 11.09.2025, të paraqitur nga z. A.D, kundër Shoqërisë LIMITLESS FITNESS sh.p.k, me Nipt M21311058S, me përfaqësues ligjor z.P. P, Administrator, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “gjinisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi A.D parashtron si vijon:

“Unë jam klient i palestrës “Limitless Fitness Toptani” në Tiranë. Gjatë publikimeve të fundit të tarifave mujore të abonimeve, kjo palestër ka aplikuar çmime të ndryshme mbi bazën e gjinisë: më të larta për meshkujt dhe më të ulëta për femrat. Këtë fakt e kam dokumentuar përmes foto/story nga rrjetet sociale të palestrës. Ky diferencim çmimesh është një formë e qartë diskriminimi gjinor, i ndaluar nga ligji nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 20-22 dhe ligji nr.9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Pas një komunikimi me biznesin për këtë praktikë, përgjigja e dhënë ishte tallëse dhe jo serioze: më thanë se “çështja do t’i dërgohej bordit” dhe se “po pritet një VKM e qeverisë për t’u miratuar”. Kjo tregon mungesë vullneti për të respektuar ligjin dhe për ta korrigjuar menjëherë diskriminimin. Si qytetar me shtetësi shqiptare dhe franceze, theksoj se këto praktika bien ndesh jo vetëm me legjislacionin shqiptar por edhe me standardet europiane për të drejtat e njeriut ku Shqipëria është e angazhuar në kuadër të procesit të integritimit.”

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit, korrigjimin e praktikave diskriminuese dhe marrjen e masave të parashikuara nga ligji ndaj subjektit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh, ndërsa garanton në mënyrë të shprehur mbrojtje nga diskriminimi për shkak të *gjinisë*. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Sipas nenit 20, pika 1, germa “b”, të LMD, përcaktohet se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1294/1 prot datë 22.09.2025, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion nga Shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Në kushtet kur subjekti nuk ktheu përgjigje, me shkresën nr.1294/2 prot datë 16.10.2025, Komisioneri kërkoi në mënyrë të përsëritur informacion nga ana e Shoqërisë Limitless Fitness sh.p.k.
2. Shoqëria Limitless Fitness sh.p.k depozitoi pranë Komisionerit qëndrimin e saj, i cili u administrua me nr.1294/3 prot datë 21.10.2025, duke parashtruar ndër të tjera se:

Shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, ndër të tjera, ofron edhe shërbimin e palestrës sipas tarifave që u janë bërë me dije të gjithë personave të interesuar dhe janë frekuentues të saj, tarifa të cilat janë përcaktuar në afate një mujore, tre mujore, gjashtë mujore dhe një vjeçare.

Lidhur me këto pagesa kemi vlerësuar të ofrojmë tarifa të ndryshme për anëtarët femra në raport me ata meshkuj. Ky dallim në tarifa/çmim nuk është bërë si masë diskriminuese, por si masë pozitive për të nxitur pjesmarrjen e grave në aktivitet fizik në përputhje me nenin 11, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Në kuptim të kësaj dispozite, masat e përkohshme, të cilat synojnë përshpejtimin e arritjes së barazisë reale, në kushtet kur ka një mungesë të barazisë sipas gjinisë në fushën e aktiviteteve sportive, për shkaqe që nuk lidhen me subjektin tonë, nuk konsiderohen diskriminim, por një veprim apo masë pozitive, e cila ka për qëllim final pikërisht barazinë reale ndërmjet meshkujve dhe femrave në këto lloj aktiviteteve. Pra, vetë ligji lejon marrjen e masave të caktuara me karakter të përkohshëm në funksion të arritjes së barazisë reale faktike, sikurse kemi vepruar edhe ne.

Statistikat tregojnë se pjesmarrja e grave në palestër është dukshëm më e ulët se ajo e burrave, për rrjedhojë aplikimi i tarifës më të ulët synon të rrisë pjesmarrjen e grave si politikë promovuese dhe jo përjashtuese. Masat pozitive që kemi ndërmarrë kanë karakter të përkohshëm dhe do të rishikohen në momentin që arrihet balancimi gjinor i anëtarëve.

Në palestrën tonë aktualisht aplikohet një tarifë standarte prej 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për femra dhe 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për meshkuj. Ky dallim tarifor është i përkohshëm dhe bazohet në një politikë promovuese që synon rritjen e pjesmarrjes së femrave në aktivitet sportiv. Ky dallim tarifor nuk përbën diskriminim në kuptim të nenit 3, të ligjit nr.10221/2010, sepse:

- Qëllimi i masës është legjitim dhe proporcional në përputhje me nenin 11, të ligjit nr.10221/2010, që lejon marrjen e masave të përkohshme pozitive me qëllim arritjen e barazisë faktike mes meshkujve dhe femrave;
- Politika e zbritjes për femrat është jopërjashtuese, por përfshirëse dhe nuk cenon të drejtat e meshkujve pasi nuk i kufizon në hyrjen apo shërbimin ndaj tyre;
- Kjo masë ka natyrë të përkohshme dhe do të rishikohet periodikisht në momentin që arrihet balancimi gjinor në regjistrimin e anëtarëve të palestrës;

- Qëllimi i saj është të promovojë pjesmarrjen e femrave në aktivitet fizik në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare që nxisin barazinë gjinore në sport.

Thënë sa më sipër, dallimi në tarifat e abonimit përbëjnë masë të përkohshme pozitive dhe jodiskriminim gjinor pasi synon një qëllim pozitiv të interesit publik, atë të barazisë faktike në aksesin në sport; është një masë proporcionale; është një masë e përkohshme; nuk përjashton apo kufizon trajtimin e barabartë të klientëve meshkuj.

3. Ankuesi depozitoi prapësimet e tij në lidhje me përgjigjen e dërguar nga subjekti, nëpërmjet *e-mail*-it të datës 05.11.2025, duke parashtruar ndër të tjera se:

Subjekti pretendon se dallimi në tarifa përbën “masë të përkohshme pozitive” në kuptim të nenit 11 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ky pretendim është i pabazuar për disa arsye thelbësore:

Masat e përkohshme pozitive sipas ligjit kërkojnë që të jenë të përcaktuara, të dokumentuara dhe të mbështetura në të dhëna konkrete mbi pabarazinë ekzistuese. Në rastin konkret, subjekti nuk ka paraqitur asnjë studim, statistikë zyrtare apo plan të miratuar që justifikon këtë masë.

Dallimi në çmime nuk është masë promovuese, por komerciale, pasi nuk ka pasur asnjë periudhë të mëparshme “barazie tarifash” që më pas të zëvendësohej nga kjo masë. Përkundrazi, tarifa standarde ka qenë 10.000 lekë për të gjithë, dhe subjekti e ka rritur çmimin vetëm për meshkujt në 15,000 lekë, duke e paraqitur më pas si “ulje për femrat”. Kjo është qartësisht një formë diskriminimi të drejtpërdrejtë ekonomik.

Sipas vetë nenit 11 të ligjit nr. 10221/2010, masa të tilla lejohen vetëm kur janë të përkohshme, proporcionale dhe të domosdoshme për arritjen e barazisë faktike. Në këtë rast, asnjë nga këto kushte nuk është përmbushur. Nuk ka tregues se masa do të hiqet apo se është pjesë e ndonjë programi zyrtar për barazi gjinore.

Në asnjë mënyrë një biznes privat nuk mund të rishpërndajë çmimet bazuar në gjini pa bazë ligjore, sepse kjo shkel parimin themelor të trajtimit të barabartë të konsumatorëve. Ligji parashikon që masa të tilla afirmative mund të zbatohen vetëm nga institucione publike ose subjekte që zbatojnë programe të miratuara shtetërore për barazi gjinore.

Për sa më sipër, mbaj qëndrimin se veprimi i subjektit “Limitless Fitness” përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë, në kundërshtim me ligjin nr. 10221/2010 dhe parimet e barazisë gjinore në shërbimet private.

4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”, për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance

dëgjimore në datën 05.12.2025. Kjo seancë dëgjimore nuk u zhvillua, pasi Shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, njoftoi Komisionerin se ishte në pamundësi për të marrë pjesë dhe kërkoi shtyrjen e seancës për në datën 12.01.2026, për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre.

5. Me shkresën nr. 1294/6 prot datë 17.12.2025, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 12.01.2026.

Nëpërmjet *e-mailit* datë 11.01.2026, shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, paraqiti një kërkesë për shtyrjen e seancës dëgjimore, pasi për shkak të një urgjence familjare administratori i shoqërisë duhet të bënte një vizitë jashtë shtetit dhe nuk ishte e mundur prania e tij në seancën dëgjimore të datës 12.01.2026.

Në kushtet kur data e seancës dëgjimore e datës 12.01.2026 ishte vendosur me dakortësinë e shoqërisë Limitless Fitness sh.p.k dhe në mungesë të administratorit të shoqërisë, kjo e fundit mund të kishte autorizuar për të qenë prezent në seancë një përfaqësues ligjor me prokurë/autozim, Komisioneri çmoi që për të shmangur zvarritjen e procesit të mos e shtyjë seancën dëgjimore. Gjithashtu, në kërkesën e saj për shtyrjen e seancës dëgjimore, shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, nuk ka paraqitur asnjë dokument justifikues lidhur me shkakun e pretenduar të pamundësisë për të marrë pjesë në seancë dëgjimore të administratorit.

Në seancë nuk u paraqit pala ankuese, e cila më herët ka njoftuar se ndodhet jashtë shtetit dhe e ka depozituar qëndrimin e tij me shkrim me *e-mail-in* e datës 03.12.2025, në vijim të njoftimit për seancën dëgjimore të datës 05.12.2025. Pala ankuese parashtron ndër të tjera se:

Për një periudhë të konsiderueshme kohe, tarifa standarde mujore në palestrën “Limitless Fitness Toptani” ka qenë 10.000 lekë për të gjithë klientët, pa dallim gjinie. Më pas, subjekti ka vendosur të ndryshojë skemën e çmimeve, duke mbajtur 10.000 lekë si tarifë për femrat dhe duke rritur tarifën për meshkujt në 15.000 lekë në muaj. Pra, në praktikë nuk kemi një ulje reale për gratë, por një rritje çmimi vetëm për meshkujt, që më pas është paraqitur si “*promocion*” në favor të femrave. Ky ndryshim krijon një trajtim ekonomik më të pafavorshëm për meshkujt, vetëm për shkak të gjinisë, për të njëjtin shërbim dhe të njëjtin akses në palestër.

Subjekti përpiqet ta justifikojë diferencën e tarifave duke e cilësuar atë si “masë të përkohshme pozitive” në kuptim të nenit 11 të ligjit nr. 10221/2010. Nuk ka asnjë provë konkrete apo statistikë të dokumentuar që të tregojë se është bërë një analizë paraprake për pjesëmarrjen e grave dhe burrave në këtë palestër, apo që kjo masë është pjesë e një programi të miratuar për barazi gjinore. “Masa e përkohshme pozitive” sipas ligjit duhet të jetë e përcaktuar qartë në kohë, e proporcionale, e lidhur me një objektiv të matshëm për barazi faktike. Në rastin konkret, subjekti nuk ka përcaktuar asnjë afat, asnjë kriter objektiv dhe asnjë mekanizëm rishikimi të vërtetë, tarifat e diferencuara zbatohen në mënyrë të përgjithshme dhe të pacaktuar.

Qëllimi i masave pozitive nuk është që të penalizohen financiarisht një grup (meshkujt), por të krijohen mundësi shtesë për grupin që ndodhet realisht në disavantazh, nëpërmjet mekanizmave të balancuar dhe të kontrolluar. Një biznes privat që vepron për fitim nuk mund të shpallë vetë dhe në mënyrë të njëanshme “masa pozitive” për barazi gjinore, pa një kuadër të qartë programor apo vendimmarrje publike që ta mbështesë këtë.

Për këto arsye, justifikimi i subjektit me nenin 11, është i pambështetur dhe se në thelb kemi të bëjmë me diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë, në kuptim të neneve 3 dhe 20 të ligjit nr. 10221/2010, si dhe në kundërshtim me Direktivën 2004/113/EC të BE-së për barazinë gjinore në qasjen ndaj mallrave dhe shërbimeve.

Subjekti e paraqet dallimin në tarifa si “politikë promovuese” për rritjen e pjesëmarrjes së grave në sport. Megjithatë, nëse do të ishte vërtetë promovicion, do të kishte kuptim ulja e përkohshme e çmimit për një grup, pa rritur njëkohësisht çmimin vetëm për një grup tjetër në mënyrë të përhershme. Në rastin konkret, efekti real është që meshkujt paguajnë më shumë për të njëjtin shërbim, pa asnjë diferencë në orare, akses apo kushte. Kjo nuk është “promovicion”, por tarifim i pabarabartë mbi bazë gjinie.

Duke marrë në konsideratë, historikun e tarifave (10.000 lekë për të gjithë, më pas 15.000 vetëm për meshkuj), mungesën e provave reale për nevojën, proporcionalitetin dhe përkohshmërinë e “masës pozitive”, faktin që dallimi në çmime lidhet drejtpërdrejt me gjininë dhe jo me ndonjë kriter objektiv, veprimi i subjektit “Limitless Fitness sh.p.k.” përbën diskriminim të drejtpërdrejtë gjinor në kuptim të ligjit nr. 10221/2010 dhe standardeve europiane për barazi gjinore në ofrimin e shërbimeve.

Ankuesi thekson se vjen shpesh në Shqipëri dhe prej kohësh është klient i palestrës “Limitless Fitness Toptani”. E ka pëlqyer gjithmonë këtë palestër dhe ua ka rekomanduar edhe miqve të tij sa herë kanë ardhur në Tiranë dhe do të donte që të vazhdonte të shkonte aty sa herë të vijë në Tiranë. Ankuesi thekson se, është ndier i zhgënjyer jo vetëm nga politika e tarifave të ndryshme për meshkuj dhe femra, por edhe nga mënyra si u trajtua në komunikimet me mesazhe, ku shqetësimi i tij nuk u mor seriozisht. Nëpërmjet kësaj ankese, ai thekson se nuk ka për qëllim dëmtimin e subjektit, por korigjimin e një praktike që e konsideron të padrejtë dhe diskriminuese, në mënyrë që si ai, ashtu edhe klientë të tjerë, të mund të përdorin këtë shërbim pa u trajtuar në mënyrë të pabarabartë.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri që, mbi bazën e këtyre rrethanave dhe provave të administruara, të konstatojë ekzistencën e diskriminimit dhe të urdhërojë heqjen e kësaj praktike tarifimi të pabarabartë.

6. Me shkresën nr. 253 prot., datë 02.02.2026, Komisioneri kërkoi nga shoqëria Limitless Fitness sh.p.k që të depononte informacionin/dokumentacionin mbi çështjet e mëposhtme:

- Cilat janë statistikat dhe të dhënat në lidhje me pjesëmarrjen e grave dhe burrave në palestër, ku është bazuar Shoqëria “Limitless Fitness” sh.p.k për të aplikuar tarifat e diferencuara?
- Sa dhe ku është përcaktuar periudha kohore përgjatë të cilës Shoqëria “Limitless Fitness” sh.p.k parashikon të zbatohet tarifa më të ulta për gratë në raport me burrat?
- Sa kanë qenë tarifat e palestrës para aplikimit të tarifave të diferencuara midis grave dhe burrave?
- Kur kanë filluar të zbatohen tarifat e diferencuara midis grave dhe burrave?

Informacioni i sipërcituar i është kërkuar shoqërisë Limitless Fitness sh.p.k edhe me shkresën për njoftimin e seancës dëgjimore të datës 12.01.2026 (shkresa nr.1294/6 prot, datë 17.12.2025). Nga ana e shoqërisë Limitless Fitness sh.p.k nuk u depozitua informacioni i kërkuar.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, ankuesi A.D ka qenë klient në palestrën “Limitless Fitness”, me vendodhje në Qendrën Tregtare Toptani, në Tiranë, shërbim ky i ofruar nga shoqëria Limitless Fitness sh.p.k. Ofruesi i shërbimit shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, është një shoqëri tregtare e cila është krijuar dhe funksion bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe është regjistruar me Nipt M21311058S, e cila ka si objekt të veprimtarisë së saj ndër të tjera: Palestër, shërbime fitnesi, shitje suplementesh të ndryshme, pije dhe lëngje të ndryshme, bar-kafe etj. Import-export, pajisje palestere dhe suplemente për fitnes, rroba sportive etj.

Shoqëria Limitless Fitness sh.p.k ka njoftuar klientët se, duke filluar nga data 10 shtator 2025, do të ketë ndryshime në tarifat e abonimeve për burrat³. Sipas një njoftimi të vendosur në dispozicion nga pala ankuese, i cili nuk u kundërshtua nga ana e shoqërisë, ky ndryshim vjen si nevojë për të sjellë tek klientët eksperiencën më të mirë të *fitnesit*.

Referuar ndryshimeve në tarifat e abonimeve rezulton se tarifat/çmimet aktuale që aplikohen në palestër janë: Paketa 1 mujore - 10.000 lekë për gra dhe 15.000 lekë për burra; Paketa 3 mujore: 24.000 lekë për gra dhe 30.000 lekë për burra; Paketa 6 mujore: 36.000 lekë për gra dhe 40.000 lekë për burra; Paketa vjetore: 50.000 lekë për gra dhe 60.000 lekë për burra.

³ Termat e përdorur nga shoqëria janë “meshkuj” dhe “femra”, ndërsa Komisioneri do të përdor termat “burra” dhe “gra” si termat më të përshtatshëm. Përdorimi i termit “burra” përfshin edhe termin “djalë” ndërsa termi “gra” përfshin edhe termin “vajzë”.

Referuar këtij njoftimi, rezulton se, para ndryshimeve tarifat e shërbimit kanë qenë të njëjta si për gratë ashtu edhe për burrat, ndërsa me ndryshimet që kanë filluar të aplikohen pas datës 10 shtator 2025, tarifat e shërbimit kanë ndryshuar vetëm për klientët burra, në masën 15.000 lekë për paketën 1 mujore, duke pësuar kështu një rritje të tarifës me 5000 lekë krahasimisht me tarifën që aplikohet për klientet gra e cila ka mbetur e pandryshuar në masën 10.000 lekë.

Rezulton se edhe tarifat për paketat e tjera 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore kanë çmime të diferencuara për burrat dhe për gratë. Të gjitha këto paketa kanë çmime më të larta për burrat krahasimisht me gratë dhe konkretisht çmimi i paketës 3 mujore për burra është 6000 lekë më e lartë se e njëjta paketë për gratë, çmimi i paketës 6 mujore për burrat është 4000 lekë më e lartë se e njëjta paketë për gratë, ndërsa paketa vjetore për burrat është 10000 lekë më e lartë se e njëjta paketë për gratë.

Komisioneri konstaton se, për të njëjtat shërbime, ofruesi/shoqëria Limitless Fitness sh.p.k aplikon çmime për të larta për burrat dhe çmime të të ulëta për gratë. Rezulton se, gjinia është kriteri i vetëm që është përdorur nga ofruesi i shërbimit/ shoqëria Limitless Fitness sh.p.k për aplikimin e çmimeve të diferencuara. Rrjedhimisht, duke qenë burrë, ankuesi do të marrë të njëjtin shërbim me një çmim më të lartë krahasuar me gratë. Komisioneri vlerëson se, kjo përbën një trajtim të diferencuar dhe më pak të favorshëm, në bazë të gjinisë, midis personave të gjendur në një situatë të ngjashme.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi A.D i është nënshtruar një trajtimi më pak të favorshëm nga ana e ofruesit të shërbimit/Shoqërisë Limitless Fitness sh.p.k.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si *gjinia*, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen nga disriminimi për shkaqe si *seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë shkakun e diskriminimit të pretenduar nga pala ankuese, “*gjininë*”.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të LMD, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të “*gjinisë*”, pasi ofruesi i shërbimit/shoqëria Limitless Fitness sh.p.k aplikon çmime të diferencuara të abonimeve mujore në palestër, më të larta për burrat dhe më të ulëta për gratë.

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë *në radhë të parë* se shkakun e pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe *në radhë të dytë* duhet të provojë ekzistencën e tij.

Komisioneri vlerëson se “*gjinia*” parashikohet shprehimisht si një shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD dhe se, bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, qartazi, aplikimi i çmimeve të ndryshme në abonimet mujore në palestër midis burrave dhe grave, përbën një trajtim të diferencuar dhe më pak të favorshëm që bazohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek *gjinia*.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se shkakun e pretenduar të diskriminimit “*gjinia*” përbën një shkak të mbrojtur/të ndaluar nga diskriminimi dhe se faktet dhe provat provojnë se ankuesi e mbart këtë shkak.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Neni 18, i Kushtetutës, sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke u shprehur se: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”.*

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 17, i Kushtetutës, përcakton: *“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”*

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Mbështetur në nenin 17, të Kushtetutës, *Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja)*, zë një vend të veçantë në hierarkinë e normave juridike.

Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

LMD e konkretizon nenin 18 të Kushtetutës dhe është hartuar nën frymën e tij. Gjithashtu, ky ligj është përfaruar me standartet e Bashkimit Europian, konkretisht me Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime”. LMD është gjithashtu në harmoni me Kartën e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian. Për këtë arsye, kuptimi dhe zbatimi i tij duhet bërë në frymën e këtyre akteve dhe standarteve të vendosura nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Vendi ynë si vend anëtar i Këshillit të Europës dhe që ka ratifikuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duhet që të veprojë në përputhje me Konventën dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si organi që mbikëqyr zbatimin e saj.

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian, parashikon:

“Neni 21

Mosdiskriminimi

1. Ndalohet çdo lloj diskriminimi për shkaqe të tilla siç janë gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike apo sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja apo besimi, mendimet politike apo të llojeve të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, prona, lindja, aftësia e kufizuar, mosha apo orientimi seksual.

Neni 23

Barazia midis grave dhe burrave

Barazia midis grave dhe burrave garantohet në të gjitha fushat, përfshirë marrjen në punë, punën dhe shpërblimin për punën.

Parimi i barazisë nuk e pengon respektimin apo miratimin e masave që parashikojnë avantazhe të veçanta për atë gjini që është më pak e përfaqësuar.

Direktiva e Këshillit 2004/113/KE e 13 dhjetorit 2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”, parashikon ndër të tjera:

“Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Direktive është të përcaktojë një kuadër për luftimin e diskriminimit të bazuar në seks në aksesin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, me qëllim vënien në fuqi në Shtetet Anëtare të parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Direktive, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

(a) diskriminim i drejtpërdrejtë: kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme, për shkak të seksit, sesa trajtohet, ka qenë ose do të trajtohej një tjetër në një situatë të krahasueshme;

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Brenda kufijve të kompetencave të dhëna Komunitetit, kjo Direktivë zbatohet për të gjithë personat që ofrojnë mallra dhe shërbime, të cilat janë në dispozicion të publikut pavarësisht nga personi i interesuar në lidhje me sektorin publik dhe privat, duke përfshirë organet publike, dhe të cilat ofrohen jashtë fushës së jetës private dhe familjare dhe transaksioneve të kryera në këtë kontekst.

2. Kjo Direktivë nuk cenon lirinë e individit për të zgjedhur një partner kontraktual për sa kohë që zgjedhja e një individi për partnerin kontraktual nuk bazohet në seksin e atij personi.

Neni 4

Parimi i trajtimit të barabartë

1. Për qëllimet e kësaj Direktive, parimi i trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave do të thotë që:

(a) nuk do të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë bazuar në seks, duke përfshirë trajtimin më pak të favorshëm të grave për arsye të shtatzënisë dhe amësisë;

.....

5. Kjo Direktivë nuk përjashton ndryshimet në trajtim, nëse ofrimi i mallrave dhe shërbimeve ekskluzivisht ose kryesisht për anëtarët e një seksi justifikohet nga një qëllim legjitim dhe mjetet për arritjen e këtij qëllimi janë të përshtatshme dhe të nevojshme.

Neni 6

Veprim pozitiv

Me qëllim sigurimin e barazisë së plotë në praktikë midis burrave dhe grave, parimi i trajtimit të barabartë nuk duhet të pengojë asnjë Shtet Anëtar të mbajë ose të miratojë masa specifike për të parandaluar ose kompensuar disavantazhet e lidhura me seksin.”

Në nenet 2 dhe 3, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përcakton:
“Neni 2

2. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të garantojnë që të drejtat e shpallura në këtë Pakt, të ushtrohen pa kurrfarë diskriminimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare a shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.

Neni 3

Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrit dhe të gruas për t'i gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore të përmendura në këtë Pakt.”

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, parashikon në nenin 4, pika 1, se: *“1. Miratimi i masave të përkohshme të veçanta nga shtetet palë që synojnë përshpejtimin de facto të barazisë midis burrit dhe gruas, nuk konsiderohet diskriminim, siç është përkufizuar në këtë Konventë, por në asnjë mënyrë nuk duhet të ketë për pasojë ruajtjen e normave të pabarabarta apo të veçanta. Këto masa duhet të ndërpriten kur të jenë arritur objektivat e barazisë së mundësive dhe të trajtimit.”*

Komiteti për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), në Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 25, për nenin 4, paragrafi 1, të Konventës (mbi masat e veçanta të përkohshme), shprehet se:

“14. Konventa synon dimensionet diskriminuese të konteksteve shoqërore dhe kulturore të kaluara dhe aktuale, të cilat pengojnë gëzimin nga gratë të të drejtave dhe lirive themelore. Ajo synon eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, duke përfshirë eliminimin e shkaqeve dhe pasojave të pabarazisë së tyre de facto ose pabarazive substanciale. Prandaj, zbatimi i masave të veçanta të përkohshme në përputhje me Konventën është një nga mjetet për të realizuar barazinë faktike ose substanciale për gratë, sesa një përjashtim nga normat e mosdiskriminimit dhe barazisë.

18. Komiteti e sheh zbatimin e këtyre masave jo si një përjashtim nga norma e mosdiskriminimit, por më tepër si një theksim që masat e posaçme të përkohshme janë pjesë e një strategjie të nevojshme nga shtetet palë që synon arritjen e barazisë de facto ose substanciale të grave me burrat në gëzimin e të drejtave të tyre njerëzore dhe lirive themelore. Ndërsa aplikimi i masave të veçanta të përkohshme shpesh korrigjon efektet e diskriminimit të kaluar kundër grave, detyrimi i shteteve palë sipas Konventës për të përmirësuar pozitën e grave në barazi de facto ose substanciale me burrat ekziston pavarësisht nga çdo provë e diskriminimit të kaluar. Komiteti konsideron se shtetet palë që miratojnë dhe zbatojnë masa të tilla sipas Konventës nuk diskriminojnë burrat”

20. Masat e veçanta të përkohshme duhet të ndërpriten kur rezultatet e tyre të dëshiruara janë arritur dhe janë të qëndrueshme për një periudhë kohore..

21 kuptimi i vërtetë i fjalës "e veçantë" në formulimin e nenit 4, paragrafi 1, është se masat janë krijuar për t'i shërbyer një qëllimi specifik.

22. Termi “masa” përfshin një gamë të gjerë instrumentesh, politikash dhe praktikash legislative, ekzekutive, administrative dhe rregullatore, të tilla si programet e mbështetjes; alokimi dhe/ose rialokimi i burimeve; trajtim preferencial; rekrutimi punësimi dhe promovimi i targetuar. Zgjedhja e një “mase” të veçantë do të varet nga konteksti në të cilin zbatohet neni 4, paragrafi 1 dhe nga qëllimi specifik që synon të arrijë.”

Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” (LBGJ) përmban gjithashtu dispozita kundër diskriminimit gjinor. Sipas nenit 4, pika 3, të LBGJ, “Diskriminim për shkak të gjinisë” është çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim ose për pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtrimin, në mënyrë të barabartë, nga secila gjini, të të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile.

Sipas nenit 6, të LBGJ, diskriminimi për shkak të gjinisë është i ndaluar. Në pikën 1, të kësaj dispozite, shprehimisht përcaktohet: “1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t’i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet.”

Neni 8, i LBGJ parashikon aplikimin e masave të veçanta të përkohshme. Në këtë dispozitë parashikohet: “1. Masat e veçanta të përkohshme përfshijnë kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor, rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe në jetën publike, fuqizimin ekonomik dhe të pozitës së personave të secilës gjini në fushën e punës, përmirësimin në mënyrë të barabartë të nivelit arsimor, si dhe masa të tjera në çdo fushë, ku personat e njëjës gjini nuk gëzojnë pozitë të barabartë me personat e gjinisë tjetër. 2. Nuk përbëjnë diskriminim për shkak të gjinisë rastet kur organet shtetërore marrin masa të veçanta të përkohshme, përfshirë edhe dispozita ligjore, që synojnë përsheptimin e vendosjes së barazisë faktike ndërmjet femrave dhe meshkujve. Këto masa duhet të pushojnë së ekzistuari sapo të jenë arritur objektivat e barazisë gjinore, për të cilat janë krijuar.”

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund

të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (*Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues, nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁴. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁵. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”⁶

Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme⁷.

LMD (neni 3, pika 1), e përkufizon diskriminimin si *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*. Sipas LMD, një nga format e shfaqjes së diskriminimit është “*diskriminimi i drejtpërdrejtë*”. Sipas nenit 3, pika 2, të LMD, “*diskriminim i drejtpërdrejtë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: “*1. Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.*”.

⁴ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fabián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁵ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

⁶ Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

⁷ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

Në nenin 11, të LMD, sanksionohet se: “*Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshtetimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.*”

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : “*7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.*” Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit e bën edhe Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82, pika 2, si vijon : “*2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.*”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin⁸.

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës

⁸ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrezojë supozimin faktik se ka patur diskriminim.

GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara.*”⁹ Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t’i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ shprehet se: “*..... niveli i bindjes së nevojshme për arritjen e një përfundimi të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarjen e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën në rrezik.*”¹⁰

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ka mbajtur qendrimin se: “*....aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi.*”

Bazuar në përkufizimin që bën ligji për diskriminimin e drejtëpërdrejtë si një nga format e shfaqjes së sjelljeve diskriminuese, elementët kryesorë ose kyç që duhen vërtetuar janë si më poshtë:

- (i) pala ankuese është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme në krahasim me mënyrën se si trajtohen, janë trajtuar apo do të trajtoheshin të tjerët, në një situatë të ngjashme;

⁹ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147.

GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

¹⁰ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147.

GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

- (ii) shkak i pretenduar i diskriminimit nga pala ankuese është një “shkak i mbrojtur” sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;
- (iii) dhe arsyeja për këtë është shkak i pretenduar i diskriminimit.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (*diskriminimi prima facie*) se në pamje të parë ankuesi është diskriminuar për shkak të gjinisë, pasi:

- Për të njëjtat shërbime, ofruesi/shoqëria Limitless Fitness sh.p.k aplikon çmime të diferencuara, më të larta për burrat dhe çmime të të ulëta për gratë;
- Gjinia është kriteri i vetëm që është përdorur nga ofruesi i shërbimit/ shoqëria Limitless Fitness sh.p.k për aplikimin e çmimeve të diferencuara;
- Duke qenë burrë, ankuesi do të marrë të njëjtin shërbim me një çmim më të lartë krahasuar me gratë. Kjo përbën një trajtim të diferencuar dhe më pak të favorshëm, në bazë të gjinisë, midis personave të gjendur në një situatë të ngjashme.
- Gjinia, përbën një shkak të mbrojtur sipas LMD dhe rrjedhimisht trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm që bazohet në këtë shkak, gëzon mbrojtje nga diskriminimi.

Trajtimi i diferencuar/trajtimi më pak i favorshëm, jo në çdo rast përbën diskriminim. Trajtimi i diferencuar/trajtimi më pak i favorshëm, është diskriminues nëse ai nuk bazohet në një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Bazuar në barrën e provës për çështjet e diskriminimit, i takon ofruesit të shërbimit/shoqërisë Limitless Fitness sh.p.k të provojë, që aplikimi i tarifave/çmimeve të diferencuara për paketat/abonimet mujore të shërbimeve në palestër midis burrave dhe grave, bazohet në një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra, ndjek një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, ofruesi i shërbimit/shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, pretendoi se, ky dallim në tarifa/çmim është një masë pozitive për të nxitur pjesmarrjen e grave në aktivitete sportive dhe bazuar nenin 11, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm ndaj të cilit ekspozohen klientët burra nuk përbën diskriminim.

Komisioneri thekson se, distancimi nga trajtimi i diferencuar nuk është gjithmonë i mjaftueshëm për të arritur barazinë faktike. Në disa situata, duhet të ndërmarren masat e duhura për të përshtatur rregullat dhe praktikatat për të marrë parasysh dallimet midis personave.

Në kontekstin e OKB-së, këto emërtohen "masa të veçanta", ndërsa termi i BE-së i referohet si "masa specifike" ose "veprimeve pozitive". GJEDNJ i referohet si "detyrime pozitive". Këto masa, janë të nevojshme për të siguruar "barazinë substanciale" që do të thotë gëzim i barabartë i mundësive për të patur akses në të mirat që gjenden në shoqëri, dhe jo thjesht "barazi formale"¹¹. Nëse nuk konsiderohet përshtatshmëria e marrjes së këtyre masave, shtohet rreziku që praktikatat dhe rregullat të diskriminojnë personat apo grupet e personave në mënyrë të tërthortë (diskriminim i tërthortë).

Zbatimi i veprimeve pozitive, parashikohet specifikisht nga LMD në nenin 11, ndërsa i njëjti koncept nën emërtimin "masat e veçanta", parashikohen edhe nga neni 8, i LBGJ.

Zbatimi i masave të veçanta ose veprimeve pozitive, në asnjë rast, nuk mund të nënkuptojë mbajtjen në mënyrë të përhershme të standardeve të pabarabarta ose të ndryshme dhe masat ndërpriten kur arrihet objektivi i trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta. Funksionaliteti i masave të veçanta apo veprimeve pozitive si një mjet afatshkurtër dhe i jashtëzakonshëm për të sfiduar paragjykimet ndaj individëve që normalisht do të vuanin nga diskriminimi, duke favorizuar anëtarët e një grupi të pafavorizuar, përbën një standart sipas ligjit ndërkombëtar, kuadrit të Këshillit të Europës dhe BE dhe legjislacionit kombëtar. Lejimi i marrjes së masave pozitive në favor të grupeve të pafavorizuara përforcohet nga udhëzimet e nxjerra nga disa prej organeve monitoruese përgjegjëse për interpretimin e traktateve të OKB-së për të drejtat e njeriut, siç është Komiteti CEDAW.

Masat e veçanta apo veprimet pozitive duhet të jenë të përshtatshme për situatën e cila duhet ndrequr. Ato duhet të jenë legjitime në një shoqëri demokratike, të respektojnë parimet e drejtësisë dhe proporcionalitetit dhe të jenë të përkohshme. Masat duhet të hartohen dhe zbatohen sipas nevojave, të bazohen në vlerësime realiste të situatës së individëve dhe komuniteteve përkatëse.¹².

Qëllimi i deklaruar nga shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, në lidhje me vendosjen e çmimeve të diferencuara të paketave mujore të shërbimit të palestrës midis burrave dhe grave, është rritja e pjesëmarrjes së grave në aktivitete sportive, me qëllimin final arritjen e barazisë reale midis burrave dhe grave në këto lloj aktiviteteve.

Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të rritur pjesëmarrjen e grave në aktivitete sportive dhe për të siguruar një përfaqësim të barabartë gjinor përbën një qëllim të ligjshëm. Qëllimi i deklaruar për të përligjur diferencën në trajtim midis grave dhe burrave në aplikimin e çmimeve të diferencuara në

¹¹ http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf

¹² Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial (CERD), Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 32 "Kuptimi dhe shtrirja e masave të veçanta në Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor", prg. 16-18.

ofrimin e tarifave/paketave mujore të shërbimit të palestrës, duke aplikuar çmime më të ulëta për gratë dhe më të larta për burrat, përveçse duhet të jetë i ligjshëm, duhet që një qëllim i tillë realisht të ekzistojë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës ofruesi i shërbimit/shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, pretendoi se, aplikimi i çmimeve të diferencuara në ofrimin e shërbimeve të palestrës midis burrave dhe grave, bazohet në statistika që tregojnë se pjesmarrja e grave në këto lloj aktivitetesh është dukshëm më e ulët se ajo e burrave dhe për rrjedhojë, aplikimi i tarifës më të ulët synon të rrisë pjesmarrjen e grave si politikë promovuese dhe jo përjashtuese.

Pavarësisht pretendimeve të mësipërm, ofruesi i shërbimit/shoqëria Limitless Fitness sh.p.k nuk vendosi në dispozicion asnjë statistikë apo të dhënë, që të provonte pretendimin për një pjesmarrje dukshëm më të ulët të grave se ajo e burrave.

Referuar njoftimit të depozituar nga pala ankuese, nëpërmjet të cilit ofruesi i shërbimit/shoqëria Limitless Fitness sh.p.k ka njoftuar klientët për ndryshimin e tarifave/çmimeve të paketave të shërbimeve të palestrës, nuk rezulton se aplikimi i tarifës më të ulët për gratë të ketë patur synimin për të rritur pjesmarrjen e tyre, pasi në këtë njoftim komunikohet se ndryshimi i tarifave, të cilat kanë pësuar rritje për klientët burra ndërsa kanë mbetur të pandryshuara për klientet gra, ka ardhur si nevojë për të sjellë tek klientët eksperiencën më të mirë të *fitnessit*. Ofruesi i shërbimeve/shoqëria Limitless Fitness sh.p.k nuk ka ulur çmimin për gratë dhe vajzat por ka rritur çmimin/tarifën vetëm për burrat dhe djemtë. Pra, nëse do të pranonin se me të njëjtat tarifa/çmime pjesëmarrja e grave dhe vajzave dhe grave ka qenë e ulët, është e paqartë se si mbajtja e tarifave/çmimeve të njëjta do të rrisë pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në këtë lloj aktiviteti, e cila synon arritjen e barazisë reale midis burrave dhe grave.

Shoqëria Limitless Fitness h.p.k, pretendoi por nuk provoi se, cilat janë politikat kombëtare dhe ndërkombëtare që nxisin barazinë gjinore në sport, prej të cilave burojnë detyrime të kësaj natyre.

Shoqëria pretendoi gjithashtu se, masa e ndërmarë për aplikimin e çmimeve më të ulëta për klientët gra dhe vajza krahasimisht me klientët burra dhe djemë, ka karakter të përkohshëm dhe do të rishikohet në momentin që arrihet balancimi gjinor i anëtarëve.

Pavarësisht këtij pretendimi, ofruesi i shërbimit/shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, nuk dha asnjë informacion në lidhje me afatin e parashikuar të aplikimit të këtyre çmimeve të diferencuara. Mungesa e një afati për zbatimin e çmimeve të diferencuara nuk rezulton as nga njoftimi që i është dërguar klientëve në momentin e ndryshimit të tarifave/çmimeve.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, çmimet/tarifat e diferencuara midis grave dhe burrave për shërbimet e palestrës të aplikuara nga shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, nuk përbëjnë një veprim pozitiv sipas nenit 11, të LMD, pasi:

- Qëllimi për arritjen e barazisë faktike mes burrave dhe grave përbën një qëllim të ligjshëm, masa e veçantë aplikuar, pra aplikimi i çmimeve të diferencuara midis burrave dhe grave, nuk rezulton të jetë një masë e përshtatshme. Pavarësisht se ofruesi i shërbimit, e paraqet çmimin/tarifën e aplikuar për gratë dhe vajzat si politikë të zbritjes së çmimit/tarifës, faktet dhe rrethanat tregojnë se, në fakt çmimi për gratë dhe vajzat nuk është zbritur, por me tarifat e reja pas ndryshimeve të vendosura nga data 10.09.2025, çmimet e aplikuara për klientët gra/vajza duke mbetur të pandryshuara, rezultojnë më të ulëta se çmimi/tarifa për djemtë dhe burrat. Në këtë kuptim, për gratë dhe vajzat edhe pse masa paraqitet si një masë promovuese për të rritur përfshirjen e tyre në këtë aktivitet, mbajtja e çmimit/tarifës së pandryshuar nuk sjell asnjë lehtësim për këtë kategori, e cila me të njëjtat çmime të aplikuara nga ofruesi i shërbimit pretendohet se ka patur një pjesmarrje dukshëm më të ulët se burrat dhe djemtë. Në këtë mënyrë, kjo masa nuk është e përshtatshme për synimin legjitim të deklaruar, që është rritja e pjesmarrjes së grave dhe vajzave.
- Masa nuk bazohet në vlerësime të situatës reale apo të dhëna të cilat të tregojnë një nënpërfaqësim të grave dhe vajzave.
- Aplikimi i çmimeve/tarifave të diferencuara midis grave dhe vajzave dhe burrave dhe djemve nuk rezulton që të ketë një natyrë të përkohshme.

Në kushtet kur, aplikimi i çmimeve/tarifave të diferencuara midis burrave dhe grave, duke aplikuar tarifa/çmime për të larta për burrat krahasimisht me gratë, për të njëjtat shërbime, për arsyet e sipërcituara nuk përbën një veprim pozitiv, sipas nenit 11, të LMD, Komisioneri arrin në përfundimin se, ky trajtim i diferencuar dhe më pak i favorshëm, nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Sipas GJEDNJ-së, kur një diferencë në trajtim bazohet në gjini, kufiri i vlerësimit që i jepet shtetit është i ngushtë dhe në situata të tilla parimi i proporcionalitetit nuk kërkon thjesht që masa e zgjedhur në përgjithësi të jetë e përshtatshme për përmbushjen e qëllimit të ndjekur, por gjithashtu duhet të tregohet se ishte e nevojshme. GJEDNJ-ja thekson se avancimi i barazisë gjinore është sot një synim madhor në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe do të duhej të parashtroheshin arsye shumë të rëndësishme përpara se një diferencë e tillë në trajtim të mund të konsiderohet si e pajtueshme me Konventën¹³.

Komisioneri vlerëson se shoqëria Limitless Fitness sh.p.k nuk arriti të provojë se trajtimi i diferencuar (tarifat/çmimet e diferencuara midis burrave dhe grave, më të larta për burrat dhe më të ulëta për gratë) është i justifikuar objektivisht dhe i përligjur. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se praktika e aplikimit të çmimeve/tarifave të diferencuara midis burrave dhe grave, në paketat/abonimet e shërbimeve të palestrës, duke aplikuar tarifa më të larta për burrat dhe më të ulëta për gratë, nga ana e shoqërisë Limitless Fitness sh.p.k, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë

¹³ ECHR, *Konstantin Markin v. Russia* [GC], No. 30078/06, § 127, 2012.

për shkak të gjinisë. Përfundimisht, arrihet në përfundimin se ankuesi A.D është diskriminuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë nga ana e Shoqërisë Limitless Fitness sh.p.k.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri korrigjimin e praktikës diskriminuese dhe marrjen e masave të parashikuara nga ligji ndaj subjektit.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar se sjellja diskriminuese konsiston në praktikën e aplikimit të çmimeve/tarifave të diferencuara midis burrave dhe grave për të njëjtat abonime/paketa mujore të shërbimeve të palestrës nga ofruesi i shërbimit/shoqëria Limitless Fitness sh.p.k. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, duhet të jetë korrigjimi dhe eliminimi i çmimeve/tarifave të diferencuara midis burrave dhe grave për të njëjtat shërbime.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit A.D , për shkak të *gjinisë* nga ana e Shoqërisë Limitless Fitness sh.p.k.
2. Në referim të pikës 1, Shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, të marrë masa për korrigjimi dhe eliminimin e çmimeve/tarifave të diferencuara midis burrave dhe grave, për të njëjtat shërbime.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Shoqëria Limitless Fitness sh.p.k, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjinia
Fusha: Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit: Diskriminim